

**LIGJ**  
**Nr.9310, datë 11.11.2004**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË ITALISË, PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LUSHNJË-FIER DHE SUPERVIZIONI I PUNIMEVE PËR DY SEGMENTET RRUGORE LUSHNJË-FIER DHE FIER-VLORË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë, për realizimin e programit “Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet rrugore Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4414, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LUSHNJË-FIER DHE SUPERVIZIONI I PUNIMEVE PËR DY SEGMENTET VIJUESE LUSHNJË-FIER DHE FIER-VLORË”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit (MTT) dhe Qeveria e Republikës Italiane, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim (MAE-DGCS),

të quajtura më poshtë “Palë Kontraktuese”,

duke pasur parasysh që në protokollin e bashkëpunimit për tre vitet 2002-2004, Kooperacioni italian ka konfirmuar angazhimin për të financuar një ndërhyrje në sektorin rrugor të përbërë nga:

- ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier;
- supervizioni i punimeve në dy segmentet vijuese Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë.

Që në mbledhjen e 29.7.2003 Komiteti Drejtues i MAE/DGCS ka shprehur mendimin në favor të dhënies së një kredie ndihme prej 24 350 000 euro për realizimin e ndërhyrjes “Ndërtimi i segmentit rrugor Lushnjë-Fier dhe supervizioni i punimeve për dy segmentet vijuese Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë” i quajtur më poshtë programi

për çka u parashtrua,

Palët Kontraktuese kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

**Qëllimi dhe pjesët e Marrëveshjes**

Qëllimi i Marrëveshjes në fjalë është të rregullojë angazhimet përkatëse të të dyja palëve për

zbatimin korrekt të programit, duke i'u referuar veçanërisht mënyrave të dhënies së kontratave, përfshirë ato të menaxhimit, identifikimit, shpërndarjes së fondeve të kredisë së ndihmës.

Marrëveshja në fjalë është e përbërë nga 14 nene dhe 3 anekse që i janë bashkëlidhur:

1. Përmbledhja e programit;
2. Kontrata e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve (kushte të veçanta);
3. Mënyra e zbatimit dhe menaxhimit të kredisë së ndihmës.

## Neni 2

### **Objektivat e programit**

Programi propozon të përmirësojë gjendjen rrugore të rrugës Lushnjë-Fier-Vlorë, sipas kriterëve të projektimit, në përputhje me standardet europiane, duke favorizuar lëvizjen e njerëzve dhe mallrave si brenda vendit, ashtu dhe me vendet kufitare, në koherencë me prioritetet rajonale, të cilat konsiderojnë rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë pjesë përbërëse të Korridorit të VIII Pan-Europian.

## Neni 3

### **Përshkrimi i programit**

Programi është përshkruar shkurtimisht në aneksin 1 dhe ka për qëllim të arrijë rezultatet e mëposhtme:

- Të bëjë rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë të përshtatshme për nevojat e flukseve aktuale dhe të ardhshme të trafikut;
- Të garantojë nivele më të larta të sigurisë rrugore;
- Të zvogëlojë kohën e udhëtimit dhe të ulë kostot operative të mjeteve;
- Të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës të popullsisë së zonës dhe të zhvillimit ekonomik të jugut të vendit.

Zbatimi i programit përfshin veprimtaritë e ndërtimit dhe supervizionit të punimeve, të cilat do të jepen nëpërmjet procedurave të ndryshme të tenderit, të rezervuara për shoqëritë italiane.

## Neni 4

### **Institucionet e përfshira në realizimin e programit**

Institucionet e përfshira në realizimin e programit janë:

Për palën italiane:

a) MAE/DGCS, që siguron shpërndarjen e burimeve financiare me kredi, sipas mënyrave të parashikuara nga rregullorja italiane në fuqi, të treguara sintetikisht në Marrëveshjen në fjalë. MAE/DGCS, në bashkëpunim me MTT, do të ketë gjithashtu detyrën për të monitoruar ecurinë e programit dhe aftësinë e tij për të arritur rezultatet e treguara në nenin 3. MAE/DGCS do të operojë nëpërmjet zyrave kompetente për kryerjen e detyrave të tyre. Në veçanti, njësia teknike qendrore e MAE/DGCS, e quajtur më poshtë UTC, do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike, në mbështetje të realizimit të programit.

b) Mediocredito Centrale (MCC), e cila—nën udhëzimet e MAE/DGCS dhe të Ministrisë Italiane të Ekonomisë – do të nënshkruajë bashkë me Ministrinë shqiptare të Financave një marrëveshje financiare që do të rregullojë përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare, MCC do të trajtojë lëshimin e kontratave të veçanta për shpërndarjen e të ardhurave, shërbimeve dhe punimeve, nëpërmjet të cilave do të realizohen veprimtaritë e parashikuara në program. Nën kujdesin e MCC do të jetë gjithashtu sigurimi i pagesës së detyrimeve përkatëse ndaj organizmave realizuese.

c) Ambasada/UTL në Tiranë, që do të sigurojë të gjitha funksionet e natyrës teknike të nevojshme për supervizionin e saktë të ecurisë së veprimtarive. Në fushën e veprimtarive institucionale të saj, Ambasada /UTL do të sigurojë gjithashtu kontaktet e nevojshme me palët e tjera të programit, duke trajtuar, ndër të tjera, marrjen dhe transmetimin e të gjithë dokumentacionit zyrtar.

Për palën shqiptare:

a) MTT, e cila do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja në fjalë duke

përfshirë dhe strukturat e tjera kompetente shqiptare, në veçanti Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve (DPRR).

b) Ministria e Financave (MoF), e cila do të nënshkruajë marrëveshjen financiare me MCC dhe që do të trajtojë kontaktet operative me këtë të fundit dhe me bankat agjente, siç është përcaktuar në marrëveshjen financiare.

c) Struktura e PIU pranë DPRR, që do të marrë përsipër koordinimin e funksioneve të natyrës teknike dhe drejtuese të nevojshme në realizimin e programit.

#### Neni 5

#### **Burimet financiare dhe modalitetet e përdorimit të kredisë së ndihmës**

Burimet financiare të nevojshme për realizimin e programit janë si më poshtë:

1. Kredia e ndihmës prej 24 350 000 euro për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara në program.

2. Fonde të Qeverisë shqiptare, të barasvlefshme me rreth 4 900 000 euro për kostot vendore (TVSH, taksa doganore dhe shpronësime).

Format dhe kushtet e kredisë janë si më poshtë:

- periudha e rimbursimit të kredisë: 38 vjet,
- periudha e mospagimit të interesave (për rimbursimin e kredisë): 17 vjet,
- taksa e interesit vjetor: 0.10%.

Mbi bazën e procedurave në fuqi pranë MAE/DGCS, hapat kryesore për t'u ndjekur, për përdorimin e fondeve të kredisë së ndihmës janë si vijon (përcaktuar më mirë në aneksin 3):

1. Nënshkrimi i Marrëveshjes në fjalë;
2. Lëshimi nga ana e Ministrisë Italiane të Ekonomisë të një dekreti ministror që autorizon MCC të negociojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen financiare me MoF;
3. Nënshkrimi i Marrëveshjes financiare ndërmjet MCC dhe MoF;
4. Parapërgatitja e dokumenteve të tenderit për zbatimin e punimeve dhe për veprimtaritë e supervizionit;
5. Kryerja e dy tenderave dhe shqyrtimi i ofertave përkatëse, nga ana e Komisionit të Vlerësimit e krijuar nga MTT, për dhënien e dy kontratave;
6. Verifikimi nga ana e MAE/DGCS i përputhjes të procedurave të ndjekura për tenderat dhe kontratave për nënshkrim, e, në rast përfundimi pozitiv, nënshkrimi i kontratave nga ana e MTT;
7. Identifikimi i kontratave mbi Marrëveshjen financiare, me mënyrat e shpërndarjes së fondeve të treguara në aneksin 3.

#### Neni 6

#### **Monitorimi i programit**

Ecuria e programit do të monitorohet bashkërisht nga MAE/DGCS (nëpërmjet misionëve të herëpashershme të funksionarëve dhe ekspertëve të përcaktuar) dhe nga MTT. Të dyja Palët angazhohen që nga ky moment të përcaktojnë të gjitha masat që do të konsiderohen si të nevojshme të ndërmerren atëherë kur, gjatë zbatimit të programit, skema e treguesve nuk rezulton e respektuar, ose nuk vërehet më si e përshtatshme me kushtet sektoriale dhe vendore.

#### Neni 7

#### **Mënyra e blerjes së shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve**

Përzgjedhja e zbatuesve të veprimtarive të programit do të bëhet nëpërmjet kryerjes së tenderave të përqasura sipas dispozitave që gjenden në manualin e procedurave (adoptuar nga Komisioni Europian më 23 dhjetor 2002), lidhur me: "Kontratat e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve në kuadër të bashkëpunimit komunitar me vendet e treta", e përcaktuar gjithashtu në aneksin 2.

#### Neni 8

#### **Detyrimet e Qeverisë shqiptare**

Qeveria shqiptare angazhohet:

- të verë në dispozicion burimet financiare që i përkasin, të barasvlefshme me rreth 4 900 000 euro;
- të bëjë operative të gjitha veprimet, veprimtaritë dhe aktet formale të nevojshme për realizimin me sukses të programit;
- të bashkëpunojë me MAE/DGCS për veprimtaritë e monitorimit të programit sipas nenit 6, si dhe për aksesin në dokumentacionet ekzistuese dhe fushave të veprimtarisë.

Neni 9

### **Detyrimet e Qeverisë italiane**

Qeveria italiane angazhohet të garantojë financimin deri në 24 350 000 euro me kredi ndihme, që do të jetë e disponueshme pranë MCC dhe do të livrohet siç përcaktohet në aneksin 3.

Neni 10

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Palëve Kontraktuese lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Marrëveshjes në fjalë do të zgjidhet, për sa është e mundur, nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave.

Neni 11

### **Pengesat dhe shkaqet madhore**

Në rast pengese të realizimit të programit, si pasojë e shkaqeve madhore (luftë, përmytje zjarr, taifune, tërmete, konflikte pune, greva, masa paraprake të qeverive përkatëse, vështirësi të paparashikuara e transporte, disa shkaqe të tjera) të njohura nga të dyja palët, ose në rast rreziku apo kushtesh të rrezikshme për personelin e çatdhesuar, do të adoptohen dispozitat në vijim, bazuar në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe miratuar nga MAE/DGCS:

- a) Nëse kohëzgjatja e pengesës së realizimit të programit është më pak se gjashtë muaj, përdorimi i fondeve të mbetura pezullohet derisa MAE/DGCS autorizon rinisjen e veprimtarive;
- b) Nëse kohëzgjatja e pengesave është më shumë se gjashtë muaj dhe më pak se njëzet e katër, programi pezullohet dhe fondet e mbetura mbahen deri sa të zgjidhet pengesa dhe të sigurohet autorizimi i MAE/DGCS për rinisjen e veprimtarive;
- c) Atëherë kur kohëzgjatja e pengesës është më shumë se njëzet e katër muaj, Palët janë të detyruara të bien dakord për vazhdimin e programit dhe të përcaktojnë rrjedhën e veprimeve. Në rast pamundësie për të vazhduar veprimtarinë, Palët duhet të vendosin mbi destinacionin e fondeve të mbetura.

Neni 12

### **E drejta për zgjidhjen e marrëveshjes së MAE/DGCS**

MAE/DGCS ka të drejtë të tërhiqet nga Marrëveshja në rastet e mëposhtme:

- a) Mungesë realizimi e veprimtarive të parashikuara në program, për shkak që jo në faj të Palës italiane;
  - b) Pengese që zgjat ose shkak madhor, sipas nenit 11.
- Në të dy rastet e përmendura më lart, MAE/DGCS mund të vendosë njëanshmërisht përfundimin e Marrëveshjes, duke njoftuar MTT nëpërmjet një note verbale, të paktën tre muaj përpara. Në çdo rast, pas një njoftimi të tillë, MTT është e detyruar të ndërpresë veprimtarinë e PROGRAMIT, përveç një Marrëveshjeje tjetër midis Palëve.

### Neni 13 **Modifikimi**

Palët mund të propozojnë në çdo moment modifikime në përmbajtjen e Marrëveshjes në fjalë nëpërmjet shkëmbimit të notave, përmes rrugëve diplomatike. Modifikimet e bëra në këtë mënyrë do të hyjnë në fuqi me të njëjtat procedura të parashikuara nga Marrëveshja për hyrjen e saj në fuqi.

### Neni 14 **Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe denoncimi**

Marrëveshja në fjalë do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë nga dy njoftimet me të cilat Palët Kontraktuese do të kenë komunikuar zyrtarisht kryerjen e të gjitha procedurave përkatëse të brendshme të ratifikimit siç parashikohet.

Marrëveshja në fjalë do të zgjasë tre vjet dhe do të rinovohet automatikisht për periudhat në vijim me kohëzgjatje të njëjtë.

Marrëveshja në fjalë mund të denoncohet në çdo moment dhe denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj mbasi i është bërë njoftimi i tij Palës tjetër Kontraktuese.

Në dëshminë e përfaqësuesve nënshkrues, të autorizuar siç duhet nga qeveritë përkatëse, kanë firmosur Marrëveshjen në fjalë.

Bërë në Tiranë më 25.2.2004, në dy kopje origjinale secila në gjuhën italiane dhe atë shqipe. Në rast mospërputhjeje të përkthimit, teksti në gjuhën italiane është ai që mbizotëron.

### ANEKSI 1 PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT OBJEKTIVAT

Objekti i përgjithshëm i programit është në përputhje me direktivat e lëshuara nga Qeveria shqiptare, të finalizuara në realizimin e një rrjeti rrugor kombëtar eficient, që favorizon lëvizjen e njerëzve dhe mallrave brenda Shqipërisë, me vendet kufitare dhe me pjesën tjetër të Europës, dhe është përfaqësuar me përmirësimin e gjendjes rrugore përgjatë Korridorit VIII-të, i cili segmenti Lushnjë — Fier — Vlorë përfaqëson shtojcën drejt Jugut të Vendit.

Objektivat e veçanta synojnë:

- të përmirësojnë gjendjen rrugore të rrugës Lushnjë-Fier-Vlorë sipas kriterëve të projektimit në përputhje me standardet europiane;
- të përshtasin rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë me nevojat e fluksit të trafikut të tanishëm dhe të ardhshëm dhe me nivele të larta sigurie;
- të zvogëlojë kohën e përshkrimit dhe të ulin kostot operative të mjeteve;
- të favorizojnë zhvillimin ekonomik të Jugut të Shqipërisë.

#### REZULTATET E PRITSHME

Veprimtaritë e projektit do të lejojnë të arrihen rezultatet e mëposhtme:

- pjesë rrugore me një segment me dy korsi për çdo drejtim lëvizjeje e përshtatshme me fluksin e trafikut të tanishëm dhe të ardhshëm;
- vepra arti (ura, mbyllësa shtonesh etj.) të rindërtuara ose të rehabilituara;
- infrastrukturë rrugore në përputhje me standardet europiane, përsa i përket ngarkesave, sigurisë dhe sinjalistikës;
- lëvizje urbane e përmirësuar në qendrat kryesore të përshkruara (Lushnjë-Fier-Vlorë), duke e ndarë trafikun vendas nga ai përshkues.

#### VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA

Punimet e ndërtimit të pjesës rrugore Lushnjë-Fier (rreth 22 km) me segment me dy korsi për drejtim lëvizjeje, nga progresiviteti km 19 -550 (e vendndodhur në fund të by-pass të Lushnjës) deri në progresivitetin rreth 41 km, përpara urës mbi lumin Seman. Nyja përfunduese e pjesës rrugore në fjalë do të lejojë, nëpërmjet një rreth rrotullimi, një lidhje racionale me by-passin e parashikuar të Fierit, që bie tërësisht në lotin vijues Fier-Vlorë (punimet e ndërtimit të të cilit do të financohen nga BEI).

Veprimtaria e supervizionit të punimeve (që do të përfshijë dhe lotin vijues Fier-Vlorë) do të kryhet në kontakt të vazhdueshëm me MTT dhe DPRR.

Nëpërmjet pranisë së vazhdueshme në kantier të personelit, veprimtaria e supervizionit do të tentojë tërësisht t'i paraprijë zgjidhjes së çdo problematike në kundërshtim me rregullin e zhvillimit të punimeve, duke siguruar kështu realizimin e veprave të projektuara në përputhje me:

- specifikat teknike të projektit;
- kostot e parashikuara në kontratën e shërbimeve, pajisjeve dhe mjeteve dhe të kohëve përkatëse të treguara në kronogramën bashkëlidhur kontratës.

## ANEKSI 2 KONTRATA E SHËRBIMEVE, PAJISJEVE DHE PUNIMEVE (KUSHTET E VEÇANTA)

Aneksi i referohet përdorimit të kredisë italiane të ndihmës.

Caktimi i kontratave do të bëhet nëpërmjet tenderit të hapur, rezervuar ndaj shoqërive italiane. Përqindja e kredisë së ndihmës të përdorshme për kostot vendore dhe/ose në vendet në zhvillim nuk mund të kalojë 50% të vetë kredisë.

Për caktimin e të gjitha kontratave të parashikuara në Program, do të adoptohen procedurat e parashikuara në manualin e procedurave (adoptuar nga Komisioni evropian më 22 dhjetor 2002) që ka ta bëjë me: Kontratën e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta.

Në çdo rast, procedura e seleksionimit duhet megjithatë të përfshijë:

1. Verifikimi i përshtatshmërisë së ofruesve (persona juridikë, shoqëri dhe ndërmarrje) që nuk do të konsiderohen të përshtatshëm atëherë kur:

a) Janë në gjendje falimentimi, likuidimi, administrimi të kontrolluar ose preventivi të njëjtë, mbyllje veprimtarie ose që janë objekt i një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtarë;

b) Janë objekt i një procedure të deklarimit të falimentimit, likuidimit, administrimit të kontrolluar, preventivi të njëjtë ose i një procedimi të ngjashëm të parashikuar nga ligjet dhe rregullat kombëtare;

c) Kanë marrë një dënim që nuk kundërshtohet për një vepër që ka të bëjë me moralin profesional;

d) Janë bërë përgjegjës për dhunime të rënda të detyrimeve profesionale, të provuara këto me çdo lloj elementi të dokumentuar nga administratat vlerësuese;

e) Nuk janë në rregull me detyrimet në fushën e kontributeve shoqërore sipas dispozitave legjislative të vendit në të cilin janë vendosur;

f) Nuk janë në rregull me detyrimet në fushën e taksave dhe tatimeve sipas dispozitave legjislative të vendit në të cilin janë vendosur;

g) Janë bërë fajtorë për mossaktësi të rënda në dhënien e informacionit të kërkuar nga administrata vlerësuese, për sa u përmond më lart;

h) Janë deklaruar fajtorë për shkak të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, të mosplotësimeve të rënda në fushën e zbatimit, lidhur me një kontratë tjetër të nënshkruar me të njëjtën administratë vlerësuese ose me një kontratë tjetër të financuar nëpërmjet fondeve të komunitetit.

Për sa më sipër ofruesit italianë janë të detyruar të paraqesin një certifikatë ose një deklaratë të vlefshme që nuk i përkasin kategorisë së treguar në dekretin legjislativ italian 8 gusht 1994, nr.490 ("antimafia").

Për rrjedhojë ofruesit duhet të paraqesin në mbështetje të ofertave të tyre, provat përkatëse konform legjislacionit të vendit në të cilin janë vendosur, duke vërtetuar se ata nuk gjenden në asnjë nga situatat e parashikuara në pikat a, b, c, e dhe f.

2. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe financiare i ofruesve nëpërmjet:

a) Një deklaratë të kapitalit financiar të shoqërisë dhe të xhirove në 3 vitet përpara tenderit.

b) Një deklaratë të faturimeve gjithsej të konkurruesve dhe, në rast të një shoqërie të përkohshme faturimin e secilit pjesëmarrës.

c) Një deklaratë që tregon faturimin e sektorëve të veçantë, për të cilët referohet tenderi ose sektori në të cilin, në rast shoqërie të përkohshme, shoqëria individuale ka për të qëllim të kontribuojë.

d) Një deklaratë të përshtatshme e përfaqësuesve ligjorë ose një certifikatë bankare që përmban informacione mbi marrëdhëniet me institucionet bankare të nivelit ndërkombëtar, që tregojnë

pranueshmërinë financiare dhe tregtare të konkurrentëve dhe të shoqërive që përbëjnë shoqërinë e përkohshme.

e) Një kopje e certifikatës që vërteton që konkurenti është pjesëtar i Dhomës së Tregtisë në vendin që është vendosur.

f) Në rast shoqërie të përkohshme duhet të paraqitet një kopje e kontratës së shoqërisë së përkohshme ku tregon shoqërinë që merr përsipër rolin e liderit përgjegjës përballë MIE në rast ekzekutimi të kontratës.

3. Verifikimi i aftësive teknike dhe profesionale të konkurrenteve nëpërmjet:

a) Kopje e dokumentave origjinale që vërtetojnë gjendjen zyrtare dhe/ose statusin juridik, që vërtetojnë vendin e regjistrimit dhe/ose zyrën qendrore ose zyrën e regjistrimit dhe nëse nuk përputhen, vendqendrimi i selisë kryesore të firmës, shoqërisë ose *joint venture*, ose të palëve të ndryshme që përfaqësojnë konkurrentin në rast shoqërie të përkohshme.

b) Një raport që përmban informacione të dokumentuara mbi eksperiencat e mëparshme të punës të konkurrentëve ose të shoqërisë së përkohshme në tendera të llojit të ngjashëm, përgjatë tre viteve të fundit, dhe të tenderave të tjerë me informacione të veçanta rreth efektivitetit dhe pjesëmarrjes konkrete në çdo tender.

c) Kualifikimet dhe eksperiencat e anëtarëve kryesore të stafit që do jenë të ngarkuar nga kontraktuesi për zbatimin e kontratës.

d) Një raport i shkurtër mbi veprimtarinë e konkurrentëve, vetëm ose të bashkuar që i referohet në mënyrë veçanërisht veprimtarive të lidhura me programin.

Krahasimi i konkurrenteve mbi bazën e kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, do të bëhet duke përdorur kriteret e parashikuara dhe çmimin për identifikimin e konkurruesit ekonomikisht më në avantazh.

Kriteret duhet të jenë të saktësuar, jodiskriminuese, për ta vlerësuar të saktë konkurruesin.

### ANEKSI 3

#### MËNYRA E EKZEKUTIMIT DHE MENAXHIMIT TË KREDISË SË NDIHMËS

#### PJESA 1

#### LËSHIMI I NJOFTIMIT TË TENDERIT, PROCEDURA E APLIKIMIT

Dokumentacioni duhet të jetë i përgatitur në përputhje me aneksin 2, që ngjan me manualin e procedurave (adoptuar nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002), që ka të bëjë me kontratën e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve në kuadrin e bashkëpunimit komunitar me vendet e treta. Dokumentacioni në çdo rast duhet:

- Të përcaktojë “kushte të veçanta” që kanë lidhje me secilin tender;
- Të shpjegojë kriteret e vlerësimit që do të adoptohen nga komisioni i krijuar nga MTT.

#### 1. Përgatitja e dokumentacionit të tenderit

MTT do të përgatisë dokumentacionin e tenderit për përzgjedhjen e kontraktorit (Punime dhe supervizioni i punimeve) dhe do t’ia transmetojë Ambasadës/UTL bashkë me kërkesën për të publikuar njoftimin e tenderit në gazetatat italiane.

#### 2. Verifikimi i përputhjes së dokumentacionit të tenderit

Verifikimi i përputhjes me Marrëveshjen në fjalë do të kryhet nga MAE/DGCS dhe do të konsistojë, sidomos mbi:

- Përmbajtjen me karakter ligjor me procedurat e treguara në aneksin 2;
- Teknikat e veçanta dhe parametrat e vlerësimit me objektivat që propozon të arrijë).

### 3. Publikimi i njoftimit

Në rast verifikimi pozitiv, njoftimet e tenderit do të publikohen, nga ana e MAE/DGCS në gazetat e përditshme italiane, në Buletinin e Kooperacionit dhe në faqen e internetit të MAE. MTT do të procedojë njëkohësisht me publikimet të njoftimeve në të përditshmet kombëtare.

## PJESA II

### FAZA E VLERËSIMIT - PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Ekzaminimi i ofertave të parashikuara për çdo tender do të kryhet nga një Komision Vlerësimi i krijuar posaçërisht nga MTT. PIU pranë DPRR do të ndjekë ecurinë e çdo tenderi, duke asistuar — nëse nevojitet — dhe Komisionin. Megjithatë në mbledhjet e Komisionit nuk mund të marrë pjesë personeli italian që operon pranë Ambasadës /UTL ose i dërguar me mision nga DGCS.

2. Për çdo tender, PIU do t'i transmetojë Ambasadës/UTL dokumentacionin që përmban aktet e Komisionit, së bashku me kontratën për nënshkrim, duke kërkuar lejimin për nënshkrimin e kontratës. Një dokumentacion i tillë do t'i transmetohet nga Ambasada/UTL, MAE/DGCS, me komentet e bëra.

3. MAE/DGCS do të verifikojë kryesisht përgjigjen ligjore dhe teknike të vlerësimit të kryer me procedurat dhe kriteret/parametrat e parashikuara në kushtet e kontratës së tenderit Ambasadës/UTL, mbi rezultatin e tyre.

Në rast rezultati pozitiv (nulla osta) MTT-ja do të procedojë me nënshkrimin e kontratave me shoqërinë që rezulton fituese.

## PJESA III

### FAZA E IDENTIFIKIMIT TË KONTRATATEVE DHE SHPËRNDARJES, PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Kontratat e formalizuara nga shoqëritë fituese dhe MTT duhet t'i shkojnë MAE/DGCS nëpërmjet Ambasadës/UTL, së bashku me kopjen e performance bond dhe të lartpërmendurit nulla osta, me deklaratën e impenjimit nga pala shqiptare për të përballuar kostot vendore (TVSH, taksa doganore, shpronësime etj.)

2. Pasi të marrë dhe ekzaminojë dokumentacionin, MAE/DGCS do të marrë masa për të autorizuar Mediocredito Centrale për të përfshirë kontratat në Marrëveshjen financiare.

3. Mediocredito Centrale do t'i kërkojë firmave italiane të interesuara një “deklaratë impenjimi që të ardhurat dhe shërbimet të jenë me origjinë italiane dhe se shpenzimet që mund të kryhen në vend dhe/ose në vendet e treta të industrializuara nuk mund të kalojnë vlerën e përcaktuar në çdo kontratë, për më tepër një certifikatë antimafia. Njëkohësisht, Mediocredito Centrale do t'i kërkojë huamarrësit shqiptarë përcjelljen e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe të letrës së udhëzimeve për bankën agjente.

4. Pas tërheqjes së tërë dokumentacionit që përmendet në pikën 3, Mediocredito Centrale do t'i komunikojë huamarrësit, bankës italiane agjente dhe PIU-t pranë DPRR përfshirjen e kontratave në Marrëveshjen financiare dhe mundësinë e financimit të tyre. Plotësimi i një procedure të tillë do të lejojë shpërndarjen e “pagesës paraprake” ose të parashikuar në kontratat e veçanta dhe në përcaktimin e datës së hyrjes në fuqi.

5. Për sa i përket të gjitha pagesave të tjera, këto mund të jenë të disponueshme vetëm pas miratimit nga ana e MTT për kryerjen e pritshme të shërbimeve të parashikuara në kontratat e veçanta.